



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

MBI RISHPALLJEN E PLATFORMAVE TË PARTNERITETIT

FTESË PËR PJESËMARRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e institucionit kryesues për *Kapitullin 15 "Energjia"* po organizon tryezën e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dedikuar këtij kapitulli.

Kapitulli 15 përbën një prej kapitujve të *acquis* së Bashkimit Evropian dhe është një ndër kapitujt për hapjen e *Cluster*-it të 4-rt të negociatave të anëtarësimit. Një nga detyrimet kryesore të Shqipërisë në këtë fazë të integritit është edhe përafrimi i legjislacionit. Në këtë kuadër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me institucionet e saj kontribuese, harton dhe miraton masat ligjore për përafrim me legjislacionin e BE-së nëpërmjet Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

Në përmbushje të detyrimeve tona të përbashkëta sa i takon integritit të Shqipërisë në BE, kjo *Tryezë Partneriteti* do t'i japë mundësinë të gjitha palëve që të sigurojnë një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe profesional. Prania dhe njohuritë tuaja janë një faktor i pazëvendësueshëm në mbështetje të këtij procesi që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e vlerëson në mënyrë të veçantë.

Për të qenë pjesë e kësaj tryeze ftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, mediave të cilët kanë interes për të ndarë ekspertizën e tyre në fushën e energjisë elektrike, gazit dhe naftës, energji të rinovueshme, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore (përfshirë sektorin e qymyrit), tregun e brendshëm të energjisë (hapja e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit), aksesit jodiskriminues në rrjetet e energjisë, reduktimi i varfërisë energjetike, siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi si dhe promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe efienca e energjisë si pjesë e *Kapitullit 15*.

Aplikimi kryhet duke depozituar një letër interesi ku të jenë specifikuar eksperiencat e mëparshme në fushat e mësipërme si dhe ekspertiza që mund të jepet lidhur me fushat që mbulon *Kapitulli 15 "Energjia"* dhe CV të personit apo grupimit që përfaqëson, brenda datës **13.05.2022** në adresat elektronike :

- Leandro.xhama@infrastruktura.gov.al

- Erida.sinanaj@infrastruktura.gov.al